



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0551**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Ermal Sylaj B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit 164 Rrërimi i objekteve pa leje në Komunën e Prishtinës me numër të prokurimit 616-26-3546-5-2-1, me 08.09.2026 mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Ermal Sylaj B.I. me nr. 2026/0551, e datës 31.07.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit 164 Rrërimi i objekteve pa leje në Komunën e Prishtinës me numër të prokurimit 616-26-3546-5-2-1.

2. Vertetohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, ndërkaq aktiviteti i prokurimit 164 Rrërimi i objekteve pa leje në Komunën e Prishtinës me numër të prokurimit 616-26-3546-5-2-1

3. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumen e deponuara ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtoj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.05.2026 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit 164 Rrërimi i objekteve pa leje në Komunën e Prishtinës me numër të prokurimit 616-26-3546-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 300,000.00 €.

Me 10.07.2026 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku janë rekomanduar për kontratë GOE DARDANIAA SH.P.K.; dhe Clean Work Shines SH.P.K.

Me 14.07.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 21.07.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 31.07.2026, OE Ermal Sylaj B.I., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0551, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Ermal Sylaj B.I., janë parashtruar si në vijim:

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së.

Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj. Me datë 16.06.2026 kemi pranuar Njoftim mbi Vendimin e AK për rekomandim me kontratë Grupi i Operatorëve Ekonomik (GOE) "DARDANIAA SH.P.K." dhe "CLEAN ËORK SHINES SH.P.K." si dhe B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar. Me datë 21.06.2026 ne si OE kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit, ndërsa me datë 26.06.2026 AK ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim, ka anuluar Njoftim mbi Vndimin dhe ka dërguar procedurën në Rivlerësim. Me datë 19.06.2026 na është lejuar qasja në dokumentacionin zyrtar (edhe pse kërkesa është bërë me datë 17.06.2026) dhe pas shqyrtimit të Ofertës të GOE të rekomanduar për kontratë, në bazë të dokumentacionit duke krahasuar me kërkesat si në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë kemi konstatuar se Komisioni Vlerësues kundërligjshëm ka rekomanduar për fitues një GOE të papërgjegjshëm si dhe ka eliminuar kompaninë tonë me këto shkelje: 1. Rekomandimi i jashtëligjshëm i GOE

Pretendimi 1 Grup i Operatorëve Ekonomik DARDANIAA SH.P.K.; Clean Work Shines SH.P.K., ka dorëzuar ofertën si GOE, ashtu siç paraqitet dhe në Formularin e Dorëzimit të Tenderit, mirëpo, Anëtar i GOE kompania Clean Ëork Shines SH.P.K. nuk ka plotësuar fare DEKLARATËN NËN BETIM si dhe në dosjen e tenderit mungon Certifikata e Biznesit dhe Certifikata e TVSH-së. Komisioni vlerësues ka bërë shkelje të UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 10 - 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, Paragrafi 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të

veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së, Komisioni vlerësues e ka anashkaluar këtë fakt dhe ka vazhduar me vlerësimin e tenderit deri në rekomandim për kontratë. Është mëse e qartë se Deklarata Nën Betim është Kusht Administrativ dhe mosplotësimi i saj është themelor për vazhdimin ose jo të vlerësimit. GOE i rekomanduar për kontratë NUK është i përgjegjshëm sepse NUK e ka plotësuar Kushtin Administrativ.

Pretendimi 2 Bazuar në Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT, Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 3. Paisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën valide të regjistrimit, ndërsa paisjet tjera që nuk regjistrohen OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë me dëshmi transaksioni, DUD etj) Vemendje! Në rast se OE nuk posedon pajisje mbi pronesine duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve. Marrveshja e huazimit duhet te jete ne emër të kësaj kontrate me validet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nenshkuar dhe e vulosur nga të dyja palët. Aneksi 7. LISTA E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE, Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve Nr 1: Mini ekskavator (SKIP). GOE i rekomanduar për kontratë për plotësimin e këtij kriteri ka dëshmuar se posedon Makineri për ndërtimtari (Ekskavator) sipas Dudit Doganor R 21940. Ju si AK keni kërkuar për plotësim kriteri SKIP. GOE i rekomanduar për kontratë NUK ka dëshmuar fare se i posedon SKIP por ekskavator, ekskavatori dhe skipi janë makineri të ndryshme. Aneksi 7. LISTA E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE, Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve Nr 3: Ekskavator me peshe specifike min 20 ton me levizje me rrota (gome). GOE i rekomanduar për kontratë për plotësimin e këtij kriteri ka ofruar Kontratë me Qira me kompaninë MARISA SH.P.K.. bazuar në Dudin Doganor nr. R645 ekskavatori në fjalë nuk dëshmohet se është me rrota gome si dhe në dudin doganor që i referohemi ekskavatori është me defekt ndërsa në marrëveshjen e huazimit nuk specifikohet se i njëjti ekskavator është në gjendje pune. Aneksi 7. LISTA E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE, Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve Nr rendor 10: Kabllo vazhduese te rrymes elektrike, 20m, 50m, 100m, 150m, GOE i rekomanduar për kontratë NUK ka dëshmuar fare se i posedon pajisjet: Kabllo vazhduese te rrymes elektrike, 20m, 100m, 150m, ndërsa ka dëshmuar se i posedon vetëm : Kabllo vazhduese te rrymes elektrike 50m (Fatura GLOBAL ING SH.P.K. me numër 236/2022 e datës 23.11.2022). Ju si AK në lidhje me këtë pretendim KENI PËRDOR STANDARDE TË DYFISHTA ndaj nesh sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar fare e plotëson këtë kriter për të cilin na keni eliminuar neve si OE tenderues. 2. Arsyetimi i refuzimit te tenderit tonë

Pretendimi 3 Sipas Autoritetit Kontraktues (AK) jemi eliminuar nga gara me arsyetimin se: Ju mungojnë: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri ) vitet e fundit fiskale (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 450,000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 51% kontrata të natyrës së ngjajshme. Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten kontratat, referencat ose certifikatat për kryerjen të punëve. Ku si OE-ik: për këtë pikë të kërkesës me ofertë keni prezantuar Listen me Kontrata dhe referenca më vlerë vetëm 220,850.00 euro të cilat i përgjigjen kërkesës se AK-së për punë të ngjashme, ndërsa kontratat dhe referencat tjera të dorëzuara nuk kanë të bëjnë me natyrën e punës dhe as me ngjashmërinë e punëve që kërkohen për këtë aktivitet, ka mungesë të vlerës minimale edhe për 229,150.00 euro për ta përmbushur kërkesën prej 450,000.00 euro. Sipas UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023

PËR PROKURIMIN PUBLIK/ Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar / Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm /Neni 69 i LPP-së. Në lidhje me këtë pretendim `ju sqaroj se: kriteri për plotësim ishte që Vlera minimale e te gjitha projekteve të natyrës se kontratës duhet të jetë jo ma e vogël se 450.000,00 €. Ne si Operator Ekonomik (OE) tenderues, me rastin e tenderimit kemi dorëzuar Listën e Referencave (kontratave) me Vlerën e Përgjithshme prej 1,071,703.97 Euro. Sipas kërkesës për plotësim të kriterit: “Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri ) vitet e fundit fiskale (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 450,000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 51% kontrata të natyrës së ngjajshme.” ju si AK keni kërkuar “Projektet te ngjashme te natyrës së kontratës” e jo të njëjtë. Projekte të ngjashme me këtë tender "164 Rrërimi i objekteve pa leje në Komunën e Prishtinës" janë shumica e projekteve të realizuara dhe të dorëzuara nga ne me rastin e tenderimit, shumica e tenderëve kanë punime me makineri të rëndë ashtu siç ka dhe Paramasa e këtij tenderi. Në paramasën dhe Paralogarinë e këtij tenderi ka:- Punime me makineri të rëndë (ekskavator, kamion etj.) ashtu siç ka edhe secila kontratë e realizuar si në Listën e dorëzuar;- Transporti dhe largimi i materialeve ndërtimore ashtu siç ka edhe secila kontratë e realizuar si në Listën e dorëzuar.- Punime dore dhe furnizim me materiale ndërtimore ashtu siç ka edhe secili tender në listën e dorëzuar; (Shembull: Përshkrimi i pozicionit që është pjesë përbërëse e këtij tenderi: “Furnizimi me cemento (beton) dhe betonim të pjeseve te ndryshme (muri mbrojtës nga betoni, sipërfaqe horizontale pllaka nga betoni) etj.” që është në këtë tender nuk ka të bëjë fare me titullin e këtij tenderi, dhe të gjithë tenderët e listuar kanë këto lloj furnizimesh) Realizimi i punimeve të kontratave si në Listën e dorëzuar është e ngjashme (përveç titullit të tenderit) me punimet që kërkohen të realizohen me këtë tender. Këto punime mund të kategorizohen edhe si punime “të njëjta” ndërmjet tyre sepse secila nga kontratat e realizuar posedon në vete këto punime. Bazuar në OPINIONIN e KRPP-së nr. 11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme" në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit? Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë: OPINION Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj. Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme. Në kuptim të prokurimit publik: Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës. Termi "të ngjashme" ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Shembull: Lënda e Kontratës "Furnizim me mollë". Nëse AK kërkon si dëshmi "Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro". Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatorët ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së). Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: "Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara....." Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet "të njëjta" apo "të ngjashme". Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet ti respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj

AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlere për para. Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?", KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik. Bazuar në këto që i potencuam dhe i sqaruam si më lartë, vlere e referencave e të dorëzuara si në Listë e plotëson kriteret e kërkuara "Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri ) vitet e fundit fiskale (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 450,000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 51% kontrata të natyrës së ngjashme". Komisioni i vlerësimit duhet që këto referenca ti pranojë si të ngjashme bazuar në LPP dhe në Opinionin e KRPP-së.

Pretendimi 4 Sipas Autoritetit Kontraktues (AK) jemi eliminuar nga gara me arsyetimin se: Ju si EO-ik për pikën e kërkesës nr. 3 Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT, Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 3. Paisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmojnë me librezën valide të regjistrimit, ndërsa paisjet tjera që nuk regjistrohen OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë me dëshmi transaksioni, DUD etj) Vemendje! Në rast se OE nuk posedon pajisje mbi pronesinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve. Marrveshja e huazimit duhet te jete ne emër të kësaj kontrate me validet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nenshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët. Ju si EO-ik për këtë pikë të kërkesës me ofertë keni dorëzuar listën e oaisjeve siç është kërkuar në aneksin 7 të DT-se, mirëpo disa nga paisjet e prezantuara ne listë si dhe dëshmitë e kërkuara me dokumentacion nuk i plotësojnë kërkesat e AK-së si në vijim:- Pajisja: nr.2. Lloji i mekanizmit dhe pajisjeve, Kërkesa: Ekskavator demolues BROKK (ose të ngjashëm), sasia e kërkuar 1. Operatori ekonomik ka ofruar 2 lloje të ekskavatorëve mirëpo asnjëri nuk është i ngjashëm e Ekskavator Brokk. OE-ik ka ofruar Ekskavator Hitachi ZX130 si dhe Yanmar VIO80. Ekskavator Hitachi ZX130 i ofruar me ofertë nga OE-ik ka peshë prej 14,790kg. Motor me naftë (Diezel), edhe ekskavatori tjetër i ofruar me ofertë Yanmar VIO80 ka peshe prej 8,200.00kg, motor me nafte (Dizel) te destinuar per pune ne terrene te hapura, thyerje, gërmim dhe lëvizje dheu etj. të dy paisjet e ofruara me oferte nga OE-ik nuk janë të ngjashëm me ekskavator Brokk apo të ngjashëm, pasi nuk mund të kontrollohen nga distanca me telekomandë, operatorit (shoferit) të këtyre pajisjeve mund ti rrezikohet jeta gjatë operimit në objekte të ndryshme siç është natyra e projektit, këto pajisje nuk janë elektrike, pesha e këtyre pajisjeve është shumë e madhe në krahasim me peshën e ekskavatorit Brokk, këto makineri nuk janë të destinuara për punë në hapësira të ngushta dhe kate të ndryshme të objekteve siç është natyra e kontratës.- Pajisja me nr.Rend.4 Ekskavator (buldozer) min 20 ton me lëvizje me zinxhir ose Rrota (gome), sasia e kërkuar 1. Operatori ekonomik ka ofruar 2 lloje: Ekskavator me zinxhir Marka Liebherr, Tip:R924 me peshe neto dhe bruto 25,000.00kg dhe Bobcat (ngarkues) marka Sunëard përshkrimi Makineri sheshuese dhe nivelizuese me peshe bruto dhe neto 3,400.00kg. Këto makineri nuk e plotësojnë kriterin pasi ka qene minimum 20 ton dhe nuk janë buldozer sipas kërkesës.- Pajisjet e kërkuara me nr.Rend.10. Aparat saldimi, Prerese Armaturave me dore (dana), Ceka ndorem Shufra metalike (pajsera), Kabllo vazhduese

te rrymës elektrike, 20m, 50m, 100m, 150m. OE-ik për këto pajisje nuk ka dorëzuar dëshmi fare për to por vetëm ka shënuar që janë më faturë. Në lidhje me pajisjen e parë të këtij pretendimi ju sqaroj se:- Pajisja: nr.2. Lloji i mekanizmit dhe pajisjeve, Kërkesa: Ekskavator demolues BROKK (ose të ngjashëm), sasia e kërkuar 1. Është e vërtetë se në plotësimin e këtij kriteri ne si OE tenderues kemi ofruar Ekskavator Hitachi ZX130 si dhe Yanmar VIO80. Si arsye e refuzimit të këtyre pajisjeve nga AK se “të dy paisjet e ofruara me oferte nga OE-ik nuk janë të ngjashëm me eskvator Brokk apo të ngjashëm, pasi nuk mund të kontrollohen nga distanca me telekomandë, operatorit (shoferit) të këtyre paisjeve mund ti rrezikohet jeta gjatë operimit në objekte të ndryshme siç është natyra e projektit, këto pajisje nuk janë elektrike, pesha e këtyre pajisjeve është shumë e madhe në krahasim me peshën e ekskavatorit Brokk, këto makineri nuk janë të destinuara për punë në hapësira të ngushta dhe kate të ndryshme të objekteve siç është natyra e kontratës” nuk qëndron ky arsyetim pasi që sipas kërkesës NUK është kërkuar që mekanizmi i pajisjes duhet të jetë elektrik, NUK është specifikuar pesha e pajisjes, NUK është specifikuar se pajisje duhet të kontrollohet me telekomandë. Kërkesa është Ekskavator demolues BROKK (ose të ngjashëm) e që përshkrimi “ose të ngjashme” është sqarim mjaft i qartë se nëse nuk mund të gjinden të njëjta sipas kërkesës që nuk është e sqaruar mjaft, mund të jenë të ngjashme. Në lidhje me pajisjen e dytë të këtij pretendimi ju sqaroj se:- Pajisja me nr.Rend.4 Ekskavator (buldozer) min 20 ton me lëvizje me zinxhir ose Rrota (gome), sasia e kërkuar 1 Fillimisht pajisja që ju i referoheni me numrin rendor 4, është e listuar në numrin rendor 5. Për sqarim Ekskavator (buldozer) NUK ekziston, ose është ekskavator ose është buldozher. Nëse ju keni referuar buldozherit atëherë Buldozher me rrota gome NUK ekziston ashtu siq nuk ekziston buldozher me zingjir gome. Pajisja më shumë i referohet ekskavatorit se sa buldozherit. Për pretendimin nga AK se ne si OE kemi ofruar 2 lloja të pajisjeve Ekskavator Liebherr Tip:R924 me peshe neto dhe bruto 25,000.00kg dhe Bobcat (ngarkues) marka Sunëard përshkrimi Makineri sheshuese dhe nivelizuese me peshe bruto dhe neto 3,400.00kg NUK është fare e vërtetë. Ne si OE kemi ofruar vetëm Ekskavator Liebherr Tip:R924 me peshe neto dhe bruto 25,000.00kg që i përgjigjet më së miri kërkesës për pajisjen me numër rendor 5. Në lidhje me pajisjen e tretë të këtij pretendimi ju sqaroj se:- Pajisjet e kërkuara me nr.Rend.10. Aparat saldimit, Prerese Armatuave me dore (dana), Ceka ndorem Shufra metalike (pajsera), Kabllo vazhduese te rrymës elektrike, 20m, 50m, 100m, 150m. OE-ik për këto pajisje nuk ka dorëzuar dëshmi fare për to por vetëm ka shënuar që janë më faturë. Është e vërtetë se ne i kemi referuar faturës BAU CENTER e datës 28.03.2025, me numër 0001176. Fatura e njëjtë është fakt që ekziston dhe është e lëshuar në vitin 2025 (bashkangjitur si shtojcë). Fatura e njëjtë nuk është ngarkuar gjatë tenderimit sepse gjatë ngarkimit të dokumenteve është bërë gabim teknik. Bazuar në LPP, Paragrafin 4 të Nenit Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.” Andaj Bazuar në këtë paragraf konsiderojmë se ky gabim mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë sepse e pajisja e njëjtë është dorëzuar me rastin e tenderimit. Gjithashtu Ju si AK mund ti referoheni Paragrafit 38.3 të Nenit 38 - Sqarimi i Tenderëve - RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES

NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar), citoj: “38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.”

Pretendimi 5 Bashkangjitur gjeni Sqarimin e dates 30.06.2026, sepse për shkak të fotografive nuk pasqyrohen ashtu siq janë. Sipas Autoritetit Kontraktues (AK) jemi eliminuar nga gara me arsyetimin se: Ju si OEik: Me ofertë keni dorëzuar ofertën financiare (paramasen dhe parallogarine) me gabim aritmetik ( -18%). Ky gabim aritmetik është gjetur në fazën e rivlerësimit të A.P., ku ju ka njoftuar përmes letrës standarde B49 si në vijim: Autoriteti Kontraktues: për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur në kemi korrigjuar gabimin (gabimet) duke bërë amendamentet vijuese të tenderit të juaj: Sektori i Prokurimit - KK-Prishtinë 5- RIKAPITULLIMI Grupin e I-rë: Te Pjesa A-I – MAKINERIA DHE MJETET E PUNË - keni kalkuluar gabimisht totalin e pozicionit të rikapitullimit, ku keni vendosur vlerën prej 605,00 Euro, e që në realitet duhet të jetë 363,00 Euro ( $605.00 \times 60\% = 363.00$ ).- RIKAPITULLIMI Grupin e II-të: Te Pjesa A-II – TRANSPORTI, MATERIALET NDERTIMORE DHE PUNTORËT FIZIK - keni kalkuluar gabimisht totalin e pozicionit të rikapitullimit, ku keni vendosur vlerën prej 130.00 Euro, e që në realitet duhet të jetë 52,00 Euro ( $130.00 \times 40\% = 52.00$ ).- Vlera e ofertës tuaj pas korrigjimit të gabimit aritmetik është 622.00 euro e jo siç keni paraqitur çmimin në formular të tenderit si dhe në paramasë në vlerën 735.00 euro. Gabimi juaj aritmetik është ( $\pm 18\%$ ) Bazuar në LPP dhe në Rregullore Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik, nën 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, pika 40.9 paragrafi b. Në rast se shuma e korrigjuar është me shumë se  $\pm 2\%$ , AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42. Në lidhje me këtë pretendim ju sqaroj se: Bazuar në Dosjen e Tenderit (DT) tek pjesa e “Kritereve për dhënien e kontratës” në DT nuk specifikohet se Çmimet duhet të poentohen apo “Çmimi total i peshuar” sipas poentimit apo “Sipas peshimit (peshave) në %, të grupit të pozicioneve të përcaktuara në në dosjen e tenderit si dhe të Lista e çmimeve-oferta financiare” apo ndonjë verzion tjetër që mund ta specifikojë se duhet të peshohen çmimet. Foto 1 - Dëshmia si është e paraqitur në Dosjen këtij e Tenderi

Gjithashtu dhe më e rëndësishmja: në Paramasën e këtij tenderi në rekapitullimin total ose në paramasë askund nuk specifikohet se duhet të vendosen çmimet sipas poentimit. Në këtë paramasë nuk ka ndonjë kolonë apo rubrikë që duhet të vendoset çmimi i poentuar. Bazuar në praktikën e deritanishme dhe në shembujt e Paramasave tjera të tenderëve që duhet të vendosen me çmime të poentuara, të gjitha paramasat tjerat (përveç të kësaj dosje tenderike) e kanë të veçantë ose një kolonë që duhet të vendoset çmimi i poentuar ose në Rekapitullim Total e kanë këtë rubrikë për vendosje. Shembuj:

Foto 3 - Dëshmia si është kërkuar në këtë Dosje Tenderi

Foto 5 - Dëshmia si është e paraqitur në Paramasat e Dosjeve tjera të Tenderave

Foto 7 - Dëshmia si është e paraqitur në Paramasat e Dosjeve tjera të Tenderave

Këto janë vetëm disa nga shembujt se kur duhet të vendosen çmimet me metodën e poentimit. Kjo arsye e eliminimit NUK qëndron pasi që në “B49 - Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit llogaritje e gabuar” ju si AK i referoheni “Pasi që gabimi i evidentuar është më shumë se plus/minus dy përqind ( $\pm 2\%$ ) i vlerës totale të ofertës dhe i çmimit të poentuar” ndërsa askund

në DT dhe në Paramasë nuk citohet fjala “Poentim” por në paramasë citohet “Vlerësim”. Përqindja e vlerësimit mund të jetë politikë e brendshme e Autoritetit Kontraktues për vlerësime të ofertave. Përfundim Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka bërë shkeljen e deklaratës nën betim Sipas Neneve 1,11 dhe 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 duke mos zbatuar detyrën për të cilën edhe e ka nënshkruar këtë deklaratë duke eliminuar kompaninë tonë për kritere të kanë mundur të kërkohet sqarim si dhe në të njëjtën kohë ka shpallur të përgjegjshëm dhe pretendent për nënshkrim të kontratës edhe një Grupi të Operatorëve Ekonomik pasi siç edhe shtjelluam më lartë nuk ka kaluar kushtin administrativ. Me eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit dhe me shpalljen fitues të GOE i cili është i pa përshtatshëm dhe i pa përgjegjshëm AK e ka favorizuar drejt për se drejti GOE ne e rekomanduar për kontrate ndërsa na ka diskriminuar dhe na ka dëmtuar neve drejt për se drejti. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Me këtë veprim zyrtarët e AK kanë bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin ekonomikisht më të favorshëm. Duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë kërkojmë nga AK që ta rishqyrtoni edhe një herë vendimin sepse është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), konkretisht e: Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi (LPP) Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve (LPP) Pretendimi ynë është i bazuar në dëshmi dhe fakte të cilat lehtësisht mund të verifikohen, dëshmi të cilat i potencuam edhe më lartë, prandaj kërkojmë që NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES –B 58 i këtij tenderi të anulohet dhe të aprovohet kërkesa jonë për rivlerësim të tenderit, dhe pas një vlerësimi korrekt të shpallemi NE si fitues i tenderit në fjalë. Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni Kërkesën tonë për Rishqyrtim në mënyrë meritore dhe të nxjerrni këtë: VENDIM APROVOHET, si e bazuar Ankesa e OE ERMAL SYLAJ B.I. të anulohet "Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues" për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht kërkojmë që të ktheni tenderin në rishqyrtimin dhe rivlerësimin e këtij aktiviteti të prokurimit sipas dispozitave të LPP-së dhe duke u bazuar në kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, duke na rekomanduar kompaninë tonë fituese pasi që supozojmë që jemi të kompletuar për këtë projekt

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju, si OE, nuk i keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1 dhe 9.2, për pikën e kërkesës nr. 1.

Kërkesa nr. 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit fiskale (duke filluar nga data e publikimit të

Njoftimit për Kontratë), në një vlerë prej jo më pak se 450,000.00 €. Në rast konsorciumi, lideri duhet të ketë të paktën 51% të kontratave të natyrës së ngjashme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 1 – Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit, ku duhet të saktësohet titulli i kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe data e përfundimit, si dhe përfituesi. Listës duhet t'i bashkëngjiten kontratat, referencat ose certifikatat për kryerjen e punëve.

Ju, si OE, për këtë pikë të kërkesës, me ofertë keni prezantuar listën e kontratave dhe referencat me vlerë vetëm 220,850.00 €, të cilat i përgjigjen kërkesës së AK-së për punë të ngjashme, ndërsa kontratat dhe referencat e tjera të dorëzuara nuk kanë të bëjnë me natyrën e punës dhe as me ngjashmërinë e punëve të kërkuara për këtë aktivitet. Për rrjedhojë, ka mungesë të vlerës minimale prej 229,150.00 € për të përmbushur kërkesën prej 450,000.00 €.

Sipas Udhëzuesit nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, kur lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar, tenderi refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm, në pajtim me nenin 69 të LPP-së.

Për pikën e kërkesës nr. 3: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, sipas pajisjeve dhe mekanizimit të obligueshëm të përcaktuar në tabelën në Aneksin 7 të DT-së.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 3 – Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën valide të regjistrimit, ndërsa pajisjet e tjera që nuk regjistrohen, OE duhet t'i dëshmojë me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë me dëshmi transaksioni, DUD etj.). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet në pronësi, duhet të ofrojë marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja e huazimit duhet të jetë në emër të kësaj kontrate, me validitet të kohëzgjatjes së kësaj kontrate, si dhe të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët.

Ju, si OE, për këtë pikë të kërkesës, me ofertë keni dorëzuar listën e pajisjeve siç është kërkuar në Aneksin 7 të DT-së, mirëpo disa nga pajisjet e prezantuara në listë, si dhe të dëshmuara me dokumentacion, nuk i plotësojnë kërkesat e AK-së, si në vijim:

Pajisja nr. 2 – Lloji i mekanizmit dhe pajisjeve: Ekskavator demolues BROKK (ose të ngjashëm), sasia e kërkuar 1.

Operatori Ekonomik ka ofruar 2 lloje të ekskavatorëve, mirëpo asnjëri nuk është i ngjashëm me ekskavatorin Brokk. OE ka ofruar ekskavatorin Hitachi ZX130, si dhe Yanmar VIO80.

Ekskavatori Hitachi ZX130 i ofruar me ofertë nga OE ka peshë prej 14,790 kg dhe motor me naftë (dizel), ndërsa ekskavatori tjetër i ofruar me ofertë, Yanmar VIO80, ka peshë prej 8,200.00 kg dhe motor me naftë (dizel), të destinuar për punë në terrene të hapura, thyerje, gjermim dhe lëvizje dheu etj.

Të dy pajisjet e ofruara me ofertë nga OE nuk janë të ngjashme me ekskavatorin Brokk apo të ngjashëm, pasi nuk mund të kontrollohen nga distanca me telekomandë. Për më tepër, operatorit (shoferit) të këtyre pajisjeve mund t'i rrezikohet jeta gjatë operimit në objekte të ndryshme, siç është natyra e projektit. Këto pajisje nuk janë elektrike, pesha e këtyre pajisjeve është shumë e madhe në krahasim me peshën e ekskavatorit Brokk dhe këto makineri nuk janë të destinuara për

punë në hapësira të ngushta dhe kate të ndryshme të objekteve, siç është natyra e kontratës.

Pajisja nr. 4 – Ekskavator (buldozer) minimum 20 ton, me lëvizje me zinxhir ose rrota (gomë), sasia e kërkuar 1.

Operatori Ekonomik ka ofruar 2 lloje: ekskavator me zinxhirë, marka Liebherr, tipi R924, me peshë neto dhe bruto 25,000.00 kg, dhe Bobcat (ngarkues), marka Sunward, përshkrimi makineri sheshuese dhe nivelizuese, me peshë bruto dhe neto 3,400.00 kg.

Andaj, këto makineri nuk e plotësojnë kriterin, pasi kërkesa ka qenë minimum 20 ton dhe nuk janë buldozerë sipas kërkesës.

Pajisjet e kërkuara me nr. rend. 10: Aparat saldimi, prerëse armaturash me dorë (dana), çekan dore, shufra metalike (pajsera), kabllo vazhduese të rrymës elektrike, 20 m, 50 m, 100 m, 150 m.

OE, për këto pajisje, nuk ka dorëzuar dëshmi fare për to, por vetëm ka shënuar se janë me faturë.

Gabimi aritmetik në ofertën financiare

Ju, si OE, me ofertë keni dorëzuar ofertën financiare (paramasën dhe parallogarinë) me gabim aritmetik (+/- 18%). Ky gabim aritmetik është gjetur në fazën e rivlerësimit të AP-së, ku AK ju ka njoftuar përmes letrës standarde B49, si në vijim:

Autoriteti Kontraktues: Për të vlerësuar tenderin tuaj në mënyrë të duhur, ne kemi korrigjuar gabimin (gabimet) duke bërë amendamentet vijuese të tenderit tuaj:

RIKAPITULLIMI i Grupit të I-rë: Te Pjesa A-I – MAKINERIA DHE MJETET E PUNËS, keni kalkuluar gabimisht totalin e pozicionit 1 të rikapitullimit, ku keni vendosur vlerën prej 605.00 €, e që në realitet duhet të jetë 363.00 € ( $605.00 \times 60\% = 363.00$  €).

RIKAPITULLIMI i Grupit të II-të: Te Pjesa A-II – TRANSPORTI, MATERIALET NDËRTIMORE DHE PUNËTORËT FIZIKË, keni kalkuluar gabimisht totalin e pozicionit të rikapitullimit, ku keni vendosur vlerën prej 130.00 €, e që në realitet duhet të jetë 52.00 € ( $130.00 \times 40\% = 52.00$  €).

Vlera e ofertës tuaj pas korrigjimit të gabimit aritmetik është 622.00 €, e jo, siç keni paraqitur çmimin në Formularin e Tenderit dhe në paramasë, në vlerën 735.00 €.

Gabimi juaj aritmetik është (+/- 18%).

Bazuar në LPP dhe në Rregulloren nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 40 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, pika 40.9, paragrafi b, në rast se shuma e korrigjuar është më shumë se +/- 2%, AK do ta eliminojë OE-në dhe do ta informojë me shkrim OE-në në fjalë duke përdorur formën standarde B42.

Për arsyet e cekura më lart, jeni eliminuar.

Vlerësimi i pretendimeve ankimore

Të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë analizuar me kujdes, secila veç e veç dhe të gjitha së bashku. Me këtë rast është gjetur se të gjitha arsyet eliminuese të evidentuara nga

Komisioni Vlerësues janë të sakta, ndërsa pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Në anën tjetër, tenderuesi i rekomanduar jo vetëm që ka dorëzuar ofertë më të lirë, por edhe ofertë në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT-së, pra ofertë të përgjegjshme.

Në këtë mënyrë, është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 05.08.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0551, ndërsa me datë 17.08.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0551, me rekomandimet si në vijim: **REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, përgjigjeve të Autoritetit Kontraktues, Dosjes së Tenderit dhe dokumentacionit të ofertave, eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Duke marrë parasysh se gjatë shqyrtimit janë konstatuar mangësi në vlerësimin e dokumentacionit të pajisjeve të GOE-së së rekomanduar për kontratë, nevoja për verifikim të mëtejshme të kontratave të natyrës së ngjashme të OE ankues, nevoja për rivlerësimin e pajisjeve sipas kërkesave të publikuara në Dosjen e Tenderit dhe Paramasë, si dhe trajtimi jo i drejtë i aplikimit të peshave të çmimeve si gabim aritmetik, rekomandohet që vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës të anulohet dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim. Gjatë rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues duhet të veprojë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, dispozitat përkatëse të LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik, duke i trajtuar operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe duke marrë parasysh konstatimet e dhëna në këtë ekspertizë.

Andaj, rekomandohet që Paneli Shqyrtues ta aprovojë ankesën si pjesërisht të bazuar, ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEermal Sylaj B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0551 ka vlerësuar si në vijim:

#### Përgjigjja e pretendimit 1- I PA BAZUAR

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin e operatorit ekonomik ankues, sipas të cilit Grupi i Operatorëve Ekonomikë DARDANIAA SH.P.K. & Clean Work Shines SH.P.K. është rekomanduar për dhënie të kontratës, ndonëse anëtari i grupit Clean Work Shines SH.P.K. nuk ka dorëzuar Deklaratën nën Betim, si dhe në ofertë mungojnë Certifikata e Biznesit dhe Certifikata e TVSH-së për këtë anëtar të grupit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës rezulton se Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka dorëzuar Deklaratën nën Betim, ndërsa në ofertë janë paraqitur edhe dokumentet administrative të kërkuara për operatorët ekonomikë në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i operatorit ekonomik ankues, se Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk ka dorëzuar Deklaratën nën Betim dhe dokumentacionin administrativ të kërkuar, nuk mbështetet në dokumentacionin e ofertës.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar.

#### Përgjigjja e Pretendimit 2 – PJESËRISHT I BAZUAR

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Aneksit 7 dhe dokumentacionit të GOE-së së rekomanduar për kontratë, vlerëson se Autoriteti Kontraktues është i obliguar që gjatë vlerësimit të zbatojë në mënyrë të njëjtë kërkesat dhe dëshmitë dokumentare të përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit për të gjithë operatorët ekonomikë.

Sa i përket Mini ekskavatorit (SKIP), nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme se pajisjet e deklaruar përmbushin pikërisht kërkesën teknike të përcaktuar nga AK. Vetëm deklarimi i pajisjes në Aneksin 7 nuk është i mjaftueshëm nëse dokumentacioni mbështetës nuk e konfirmon karakteristikën e kërkuar.

Sa i përket Ekskavatorit minimum 20 ton me lëvizje me goma, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se është deklaruar Liebherr A922, me goma dhe me peshë mbi 20 ton, prandaj kjo pjesë e pretendimit nuk mbështetet në dokumentacionin e ofertës.

Ndërsa për kabllot vazhduese 20 m, 50 m, 100 m dhe 150 m, AK duhet të verifikojë nëse GOE ka paraqitur dëshmi të pronësisë për secilën nga pajisjet/gjatësitë e kërkuara. Nëse dëshmia dokumentare ekziston vetëm për një pjesë të tyre, atëherë kriteri nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm mbi bazën e deklarimit në Aneksin 7. Kjo është veçanërisht relevante nëse për të njëjtën kërkesë OE ankues është eliminuar për mungesë të dëshmimeve përkatëse, pasi AK duhet të aplikojë standard të njëjtë të vlerësimit dhe trajtim të barabartë ndaj të gjithë tenderuesve.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi nr. 2 është PJESËRISHT I BAZUAR dhe rekomandon që AK, gjatë rivlerësimit, të verifikojë dokumentacionin për pajisjet e kontestuar dhe të zbatojë kërkesat e Dosjes së Tenderit në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë.

### Përgjigjja e pretendimit 3-PJESËRISHT I BAZUAR

Eksperti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues, në pajtim me nenet 51 dhe 69 të LPP-së, ka të drejtë të kërkojë dëshmi për kontrata të realizuara të natyrës së ngjashme, mirëpo gjatë vlerësimit është i obliguar ta zbatojë kriterin ashtu siç është përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Meqenëse AK ka kërkuar “kontrata të natyrës së ngjashme” dhe jo “kontrata të njëjta”, vlerësimi i kontratave nuk mund të bëhet vetëm në bazë të titullit të tyre, por duhet të analizohet përmbajtja konkrete e punëve të realizuara, paramasa, referencat dhe certifikatat përkatëse.

Nga ana tjetër, fakti se OE ankues ka paraqitur Listën e Kontratave me vlerë të përgjithshme 1,071,703.97 € nuk dëshmon vetvetiu përmbushjen e kriterit prej 450,000.00 €, pasi kërkesa lidhet me vlerën e kontratave të natyrës së ngjashme dhe jo me vlerën e përgjithshme të të gjitha kontratave të realizuara. Po ashtu, përdorimi i makinerive të njëjta, transporti, betonimi apo furnizimi me materiale nuk janë elemente të mjaftueshme, të marra veçmas, për ta klasifikuar një kontratë si të natyrës së ngjashme.

Duke marrë parasysh se AK ka pranuar kontrata të ngjashme në vlerë prej 220,850.00 €, për plotësimin e kriterit minimal prej 450,000.00 € duhet të verifikohet nëse nga kontratat e tjera të dorëzuara nga OE ekzistojnë së paku edhe 229,150.00 € kontrata të cilat, sipas përmbajtjes së tyre reale, përfshijnë punime të rrënit, demolimit ose aktivitete ndërtimore substancialisht të krahasueshme me objektin e kontratës. Vetëm pas këtij verifikimi mund të konstatohet në mënyrë meritore nëse eliminimi i OE-së është apo nuk është në pajtim me nenet 59 dhe 69 të LPP-së.

Nëse AK nuk ka bërë një analizë kontratë për kontratë dhe është kufizuar vetëm në konstatimin e përgjithshëm se kontratat e tjera “nuk janë të natyrës së ngjashme”, eksperti vlerëson se arsyetimi i AK-së nuk është i mjaftueshëm për të verifikuar ligjshmërinë e eliminimit. Për këtë arsye Pretendimi nr. 3 vlerësohet si PJESËRISHT I BAZUAR.

### Pretendimi nr. 4 – PJESËRISHT I BAZUAR

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të kërkesave të Dosjes së Tenderit, Aneksit 7, Paramasës dhe arsyetimit të AK-së, vlerëson se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

#### 1. Ekskavatori demolues BROKK ose të ngjashëm

AK ka refuzuar pajisjet Hitachi ZX130 dhe Yanmar VIO80 me arsyetimin se nuk janë elektrike, nuk kontrollohen me telekomandë, kanë peshë më të madhe dhe nuk janë të përshtatshme për hapësira të ngushta.

Mirëpo, këto karakteristika nuk rezultojnë të jenë përcaktuar si kërkesa të detyrueshme në Aneksin 7 apo në Paramasë. Në Paramasë kërkohet ekskavator demolues BROKK ose i ngjashëm, me pajisje për demolim, si çekan hidraulik dhe pajisje të tjera përkatëse.

Sipas nenit 7 dhe nenit 28 të LPP-së, AK nuk mund të përdorë gjatë vlerësimit kritere teknike që nuk janë përcaktuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit.

Prandaj, AK duhet të vlerësojë nëse pajisjet e ofruara janë funksionalisht të ngjashme me kërkesën e publikuar dhe jo ti refuzojë për karakteristika të papërcaktuara paraprakisht.

## 2. Ekskavatori (buldozer) minimum 20 ton

Në Aneksin 7 dhe në Paramasë është kërkuar:

“Ekskavator (buldozer) minimum/mbi 20 ton, me lëvizje me zinxhir ose rrota.”

OE ka deklaruar Ekskavatorin Liebherr R924 me peshë rreth 25 ton.

Nëse nga dokumentacioni vërtetohet se Liebherr R924 është deklaruar pikërisht për këtë pozicion dhe posedon mënyrën e kërkuar të lëvizjes, atëherë pajisja e plotëson kriterin e peshës.

Arsyetimi i AK-së se pajisja “nuk është buldozer” nuk është plotësisht i qëndrueshëm, pasi vetë AK e ka formuluar kërkesën si “Ekskavator (buldozer)”.

Për këtë pjesë, pretendimi konsiderohet i bazuar, nëse dokumentacioni i ofertës e konfirmon deklarin e Liebherr R924 për këtë pozicion.

## 3. Pajisjet e pozicionit nr. 10

OE ka deklaruar aparatën e saldimit, prerëset, pajserat dhe kabllot vazhduese, por nuk ka bashkëngjitur faturën si dëshmi të pronësisë.

OE pretendon se fatura BAU CENTER nr. 0001176, datë 28.03.2025, ka ekzistuar para afatit të ofertimit dhe vetëm nuk është ngarkuar për shkak të një gabimi teknik.

Sipas nenit 72 të LPP-së dhe nenit 38.3 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK mund të kërkojë dokumente që mungojnë nëse ato dëshmojnë një gjendje që ka ekzistuar para afatit për dorëzimin e tenderëve dhe nuk krijojnë kapacitet të ri pas këtij afati.

Prandaj, nëse fatura e vitit 2025 identifikon pajisjet e deklaruara në ofertë dhe autenticiteti i saj mund të verifikohet, AK ka pasur mundësi ta kërkojë atë për sqarim para eliminimit.

### Përfundim

Eksperti shqyrtues vlerëson se Pretendimi nr. 4 është PJESËRISHT I BAZUAR.

AK nuk mund ta refuzojë pajisjen BROKK ose të ngjashme duke u bazuar në karakteristika si telekomanda, motori elektrik apo pesha, nëse këto nuk janë përcaktuar në DT.

Për Liebherr R924, nëse vërtetohet se është deklaruar për pozicionin përkatës dhe ka peshë 25 ton, kriteri duhet të konsiderohet i plotësuar sipas formulimit të Paramasës.

Ndërsa për pajisjet e pozicionit nr. 10, AK duhet të shqyrtojë mundësinë e kërimit të faturës sipas nenit 72 të LPP-së dhe nenit 38 të Rregullores, nëse fatura dëshmon gjendjen ekzistuese para afatit të ofertimit.

Për rrjedhojë, rekomandohet rivlerësimi i kësaj pjese të ofertës duke u bazuar vetëm në kërkesat e publikuara në Dosjen e Tenderit dhe Paramasë.

Pretendimi nr. 5 – I BAZUAR

Eksperti shqyrtues, pas kontrollimit të ofertës financiare, Paramasës dhe Parallogarisë së dorëzuar nga OE ankues, si dhe arsyetimit të Autoritetit Kontraktues, konstaton si në vijim:

1. Në Paramasë nuk rezulton gabim aritmetik në shumën 605.00 € dhe 130.00 €

Nga kontrollimi matematikor i pozicioneve të Pjesës A-I – Makineria dhe mjetet e punës, rezulton:

$$40 + 60 + 120 + 130 + 50 + 60 + 60 + 60 + 25 = 605.00 \text{ €}$$

Pra, shuma prej 605.00 € është aritmetikisht e saktë.

Po ashtu, për Pjesën A-II – Transporti, materialet ndërtimore dhe punëtorët fizik, rezulton:

$$10 + 5 + 5 + 60 + 20 + 30 = 130.00 \text{ €}$$

Edhe shuma prej 130.00 € është aritmetikisht e saktë.

Ndërsa për Pjesën B-I, nga Paramasa rezulton:

$$5 + 30 + 60 + 20 + 30 + 6 + 6 + 10 + 20 + 20 = 207.00 \text{ €}$$

Pra, edhe kjo shumë është aritmetikisht e saktë.

Për rrjedhojë, nuk kemi mospërputhje ndërmjet çmimeve për njësi, sasive dhe shumave të pozicioneve.

2. Shumat 363.00 € dhe 52.00 € nuk janë “korrigjim aritmetik”, por rezultat i aplikimit të peshimit

AK ka bërë këtë përlllogaritje:

$$605.00 \text{ €} \times 60\% = 363.00 \text{ €}$$

dhe:

$$130.00 \text{ €} \times 40\% = 52.00 \text{ €}$$

Ndërsa:

$$207.00 \text{ €} \times 100\% = 207.00 \text{ €}$$

Nga kjo:

$$363.00 + 52.00 + 207.00 = 622.00 \text{ €}$$

Matematikisht, përlllogaritja e AK-së prej 622.00 € është e saktë, nëse aplikohet metoda e peshimit.

Mirëpo, eksperti vlerëson se këtu duhet bërë dallim ndërmjet korrigjimit të një gabimi aritmetik në tender dhe aplikimit të peshave për qëllime të vlerësimit të ofertave.

Sipas nenit 27.14 të Rregullores për Prokurimin Publik, funksioni i peshimit të çmimit është vetëm përcaktimi i tenderit me çmimin më të ulët, ndërsa pagesa bëhet sipas çmimeve të ofruara.

Për këtë arsye, shuma 605.00 € nuk bëhet aritmetikisht e gabuar sepse pas aplikimit të peshës prej 60% rezultati për qëllime të vlerësimit është 363.00 €.

E njëjta vlen edhe për shumën 130.00 €.

Pra:

605.00 € = çmimi/subtotali real i ofertuar;  
363.00 € = vlera e peshuar për qëllime të vlerësimit.

Këto janë dy koncepte të ndryshme.

3. Paramasa nuk përmban kolonë të veçantë ku OE duhet ta llogarisë çmimin e peshuar

Nga kontrollimi i Paramasës rezulton se ajo përmban kolonat për:

- përshkrimin;
- njësinë;
- sasinë;
- çmimin me TVSH;
- totalin/shumën me TVSH.

Paramasa përmban shënimet 60%, 40% dhe 100% për vlerësim, mirëpo nuk përmban një kolonë të veçantë me emërtimin “Çmimi i peshuar/poentuar”, as formulë të vendosur ku OE detyrohet të shumëzojë subtotalin me përqindjen përkatëse.

Prandaj, shënimi i subtotalit 605.00 € dhe 130.00 € në vetvete nuk përbën gabim në mbledhje apo shumëzim të çmimeve të ofertës.

Nëse AK e përdor peshimin për krahasimin e ofertave, është detyrë e procesit të vlerësimit që çmimet e ofruara të peshohen sipas metodës së publikuar.

4. Neni 40.9 nuk duhet aplikuar automatikisht në këtë situatë

Sipas nenit 40.9 të Rregullores:

“Komisioni vlerësues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender...”, ndërsa korrigjimi nuk mund të jetë mbi 2% të vlerës totale të ofertës.

Ndërsa neni 40.10 sqaron gabimet tipike aritmetike, përfshirë rastin kur ekziston mospërputhje ndërmjet çmimit për njësi dhe totalit të fituar nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë.

Në rastin konkret, një mospërputhje e tillë nuk konstatohet.

Çmimet për njësi dhe subtotalet janë llogaritur saktë.

Ndryshimi:

605.00 → 363.00 €

nuk buron nga korrigjimi i një mbledhjeje ose shumëzimi të gabuar të OE-së, por nga aplikimi i koeficientit 60%.

Po ashtu:

130.00 → 52.00 €

buron nga aplikimi i koeficientit 40%.

Për këtë arsye, eksperti vlerëson se aplikimi i peshave të vlerësimit nuk duhet të barazohet automatikisht me “gabim plotësisht aritmetik” sipas nenit 40.9.

5. Edhe përqindja prej 18% e deklaruar nga AK nuk rezulton e saktë në raport me çmimin e ofertuar

AK ka konstatuar:

|                     |     |          |        |              |
|---------------------|-----|----------|--------|--------------|
| Oferta              | e   | OE:      | 735.00 | €            |
| Vlera               | pas | peshimit | nga    | AK: 622.00 € |
| Diferenca: 113.00 € |     |          |        |              |

Nëse përqindja llogaritet në raport me vlerën e ofertës prej 735.00 €, atëherë:

$$113 / 735 \times 100 = 15.37\%$$

dhe jo 18%.

Vlera rreth 18% fitohet vetëm nëse diferenca prej 113 € pjesëtohet me shumën 622 €:

$$113 / 622 \times 100 = 18.17\%$$

Mirëpo neni 40.9 i referohet kufirit prej 2% të vlerës totale të ofertës. Prandaj, edhe mënyra e paraqitjes së përqindjes 18% nga AK kërkon arsyetim.

Në çdo rast, si 15.37% ashtu edhe 18.17% janë mbi 2%; prandaj kjo çështje bëhet vendimtare vetëm nëse fillimisht konstatohet se kemi realisht gabim aritmetik sipas nenit 40.9.

Sipas analizës së mësipërme, eksperti nuk konstaton një gabim të tillë në subtotalet 605 € dhe 130 €.

Përfundim

Eksperti shqyrtues konstaton se 605.00 € dhe 130.00 € janë shuma aritmetikisht të sakta sipas çmimeve për njësi të ofertës.

Vlerat 363.00 € dhe 52.00 € janë rezultat i aplikimit të peshave prej 60% dhe 40% për qëllime të vlerësimit dhe jo korrigjim i një shumëzimi apo mbledhjeje të gabuar nga OE.

Rregullorja e lejon peshimin e çmimeve edhe kur kriteri i dhënies është “Çmimi më i ulët”, dhe në Paramasë peshat 60%, 40% dhe 100% janë bërë të ditura. Për këtë arsye, argumenti i OE-së se

“nuk është përcaktuar fare peshimi” nuk qëndron plotësisht.

Megjithatë, AK nuk ka bazë që vetë aplikimin e këtyre peshave ta trajtojë si gabim aritmetik të OE-së sipas nenit 40.9, përderisa subtotalet janë llogaritur saktë dhe Paramasa nuk përmban një rubrikë të veçantë ku OE ka qenë i obliguar të paraqesë rezultatin e peshuar.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit 164 Rrënimi i objekteve pa leje në Komunën e Prishtinës me numër të prokurimit 616-26-3546-5-2-1.

Paneli Shqyrtues, pasi shqyrtoi ankesën e operatorit ekonomik ankues, raportin e ekspertit shqyrtues, deklaratimet dhe përgjigjen e Autoritetit Kontraktues, dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, si dhe të gjitha provat e administruara gjatë zhvillimit të kësaj procedure, vlerëson se nuk ekziston bazë e mjaftueshme ligjore për ta pranuar rekomandimin e ekspertit shqyrtues lidhur me aprovimin apo aprovimin e pjesshëm të pretendimeve ankimore.

Sipas vlerësimit të Panelit, në pjesët ku eksperti ka propozuar rivlerësimin e ofertave, analiza nuk është mbështetur në interpretim të plotë dhe të drejtë të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullores për Prokurimin Publik dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit. Paneli çmon se në disa raste raporti i ekspertit ia ka transferuar AK barrën e verifikimit të dokumenteve, edhe pse eksperti i ka pasur të gjitha autorizimet në ofertën e dorezuar.

Lidhur me pretendimin e parë ankimor PSH ia fal besimin ekspertit në raportin e tij ngase nga dokumentacioni i administruar në procedurën e prokurimit konstatohet se Grupi i Operatorëve Ekonomikë i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar Deklaratën nën Betim dhe dokumentacionin administrativ, përfshirë dokumentet identifikuese për secilin anëtar të grupit, rrjedhimisht PSH konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar dhe se AK ka vepruar në përputhje me kushtet e parashtruara në DT.

Lidhur me pretendimin e dyte ankimor PSH nuk mbeshtete pergjigjen e dhene te ekspertit shqyrtues ne raportin e tij edhe pse vet eksperti e ka konsideruar si pjeserisht te bazuar, ashtu qe eksperti ka vlerësuar se AK duhej të kryente verifikime ekskavatorin SKIP dhe kabllot vazhduese, me arsyetimin se deklarimi në Aneksin 7 nuk është i mjaftueshëm pa kete verifikim. PSH konstaton se ky interpretim nuk është në harmoni me mënyrën e vlerësimit të ofertave të përcaktuar në DT. Sa i përket ekskavatorit, eksperti nuk ka identifikuar ndonjë mospërputhje konkrete ndërmjet kërkesave të parashtruara ne DT dhe dokumentacionit të ofertës, por është mjaftuar me konstatimin se dokumentacioni nuk është plotësisht i qartë. Një konstatim i tillë, sipas Panelit, nuk përbën bazë të mjaftueshme për të urdhëruar rivlerësim kur dihet se AK ka formuar nje komision të vlerësimit të cilët supozohen të jenë profesionale dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar *“Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”*, rrjedhimisht PSH konstaton se pretendimi ankimor eshte i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e trete ankimor PSH nuk ia fal besimin konstatimit te ekspertit per te cilin pretendim po ashtu eksperti ka vlerësuar si pjeserisht te bazuar. Eksperti ka vlerësuar se AK është dashur të analizojë secilën kontratë individualisht për të përcaktuar nëse ajo është e natyrës së ngjashme me objektin e prokurimit. PSH konstaton se një analizë e tillë është kryer nga AK gjate procesit të vlerësimit. PSH bazuar ne kete raport meqenese eksperti nuk ka identifikuar kontrata konkrete që plotësojnë kriterin e kërkuar dhe nuk ka arritur te vertetoj te kunderten me arsyetimin e AK me prova bindëse, andaj PSH vlerëson se eliminimi është bërë në përputhje me nenet 59 dhe 69 të LPP-se, rrjedhimisht pretendimi ankimor konstatohet si i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e katert ankimor PSH pajtohet me përfundimin e ekspertit se ky pretendim është pjesërisht i bazuar por duke analizuar dhe konstatuar sa i perketë pergjigjeve tjera te dhena ne kete vendim ky pretendim ankimor duke u cilesuar si pjeserisht e bazuar nuk gjene mbeshtetje te mjaftueshme ligjore per ta kthyer aktivitetin e prokurimit ne rivleresim.

Lidhur me pretendimin e peste ankimor te parashtruar nga OE ankues PSH e konstaton se Eksperti ka bërë dallimin ndërmjet aplikimit të peshimit të çmimeve dhe korrigjimit të gabimeve aritmetike, duke vlerësuar se subtotalet 605.00 euro dhe 130.00 euro janë të sakta matematikisht, ndërsa vlerat 363.00 euro dhe 52.00 euro burojnë nga aplikimi i koeficientëve të peshimit. SH vlerëson se ky interpretim nuk është në përputhje me mënyrën e përlllogaritjes së përcaktuar në Paramasë. Nga dokumentacioni i tenderit rezulton se koeficientët 60%, 40% dhe 100% janë pjesë përbërëse e metodologjisë së vlerësimit dhe operatorët ekonomikë kanë qenë të obliguar ta hartojnë ofertën në përputhje me këtë metodologji.

Për këtë arsye, paraqitja e shumave të papeshuara nuk përfaqëson vetëm një veprim matematikor të papërfunduar, por krijon mospërputhje ndërmjet mënyrës së kërkuar të përlllogaritjes dhe ofertës së dorëzuar. PSH vlerëson se AK ka vepruar drejt kur ka konstatuar se korrigjimi i këtyre vlerave do të ndikonte në çmimin e ofertës përtej kufirit të lejuar me nenin 40.9 të Rregullores për Prokurimin Publik. Po ashtu, PSH konstaton se pavarësisht mënyrës së paraqitjes së përqindjes, diferenca e konstatuar tejkalon kufirin prej 2%, çka përbën bazë të mjaftueshme për të mbështetur vendimin e AK, rrjedhimisht, pretendimi i pestë ankimor refuzohet si i pabazuar.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha

ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen se ankesa e OE ankues të aprovohet si e pjeserisht e bazuar, ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “164 Rrënimi i objekteve pa leje në Komunën e Prishtinës me numër të prokurimit 616-26-3546-5-2-1. duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Ermal Sylaj B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: